

Ekonomia e Vizave

Raport mbi koston e vizave për
kosovarët për periudhën 2010-2012

DENIED

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4
Hyrje	5
Metodologjia	6
Aplikimi i kosovarëve për viza "Shengen" 2010-2012	7
Shpenzimet e kosovarëve për viza	10
Përfundimi	14

Përmbledhje ekzekutive

Kosova është vendi i vetëm në regjionin e Ballkanit Perëndimor ndaj të cilit Bashkimi Europian (BE) aplikon regjimin e vizave. Në anën tjetër, Kosova është vendi më i varfër dhe me shkallën më të lartë të papunësisë në Europë. Përkundër kësaj, kosovarët shpenzojnë më së shumti në Europë për të aplikuar për viza. Për tri vite, 217.862 kosovarë kanë aplikuar për vizë “Shengen”: 82.405 në vitin 2010, 67.901 në vitin 2011 dhe 67.556 në vitin 2012. Mbi 17% e aplikantëve për viza refuzohen nga shtetet e zonës “Shengen”. Vetëm për këto tri vite, kosovarët kanë shpenzuar rreth 15 milion euro, prej të cilave 9 milion euro janë shpenzuar për pagesë direkte për vizat në ambasadë, kurse së paku 5.8 milion euro janë shpenzime tjera të ndërlidhura me kompletimin e dokumentacionit për vizë, shpenzimet bankare dhe ato të rrugës. Numri më i madh i aplikimeve për vizë “Shengen” është bërë në ambasadën e Gjermanisë dhe të Zvicrës. Kosova mbetet ende larg nga përmbushja e kushteve për liberalizimin e vizave, andaj kosovarët do të shpenzojnë mjete të konsiderueshme parash edhe gjatë 2013. Nëse shohim trendin e aplikimeve për çdo vit nga viti 2010, mund të pritet se edhe në vitin 2013 më shumë se 65.000 kosovarë do të aplikojnë për viza me një kosto shtesë së paku edhe për 4.5 milion euro.



Hyrje

“Marrëveshja Shengen” për eliminimin e kontrolleve kufitare brenda shteteve nënshkruese të marrëveshjes, filloi së zbatuari praktikisht më 1995, në mes të shtatë shteteve nënshkruese. Sot, përveç Bullgarisë, Rumanisë, Qipros, Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës, zona “Shengen” përbëhet nga të gjitha shtetet tjera anëtare të BE-së. Ndërkaq, edhe pse shtetet si Norvegjia, Zvicra, Islanda dhe Lihtenshtajni nuk janë shtete anëtare të BE-së, ato janë pjesë e marrëveshjes “Shengen”. Me krijimin e zonës “Shengen” ka ardhur deri te koncepti i kufirit të jashtëm të BE-së që ka implikuar një politikë të përbashkët të vizave për ato vende jashtë kësaj zone. Me anë të legjislacionit sekondar,¹ BE ka defnuar se cilat janë ato vende, qytetarët e të cilave duhet të pajisen me vizë “Shengen” për të pasur të drejtën e lëvizjes së lirë në zonën “Shengen”. Në vitin 2011, nga 26 shtete të “Shengen” - it janë lëshuar rreth 12.6 milion viza për qytetarët e vendeve jashtë zonës “Shengen”.² Megjithatë, të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor (përveç Kosovës), kanë nënshkruar marrëveshje me BE-në e cila iu mundëson qytetarëve të atyre shteteve lëvizjen pa viza në zonën “Shengen”. Në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, zakonisht kjo marrëveshje referohet si marrëveshje për liberalizimin e vizave. Kosova ka filluar dialogun me Komisionin European për liberalizimin e vizave në janar 2012 dhe mori udhëzuesin për liberalizimin e vizave në qershor 2012.

Kjo analizë e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Institutit GAP, analizon koston të cilën paguajnë qytetarët e Kosovës për të siguruar një vizë “Shengen”.

DENIED



1 Rregullore e Këshillit Nr. 539/2001 e datës 15 mars 2001: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CONSLEG:2001R0539:20110111:EN:PDF>

2 European Commission, Directorate General for Home Affairs: http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/policies/borders-and-visas/visa-policy/index_en.htm

Metodologjia

Instituti GAP dhe GLPS kanë bërë një hulumtim mbi atë se sa shpenzojnë qytetarët e Kosovës në aplikimin për vizë “Shengen”. Për të ardhur deri te një kalkulim, janë marrë për bazë statistikën e Komisionit Europian mbi numrin e aplikimeve për vizë “Shengen” gjatë viteve 2010-2012³ në Prishtinë. Më pas, varësisht se cilat ambasada janë të përfshira në dhënien e vizave sipas këtyre statistikave, është kërkuar nga ato ambasada çmimi që ato aplikojnë për kategori të vizës. Në bazë të hulumtimit, jo të gjitha ambasadat aplikojnë çmimet e njëjta, p.sh. ambasada e Belgjikës aplikon çmimin prej 35 eurove për kategoritë A, B, C të vizave dhe 180 euro për vizën D, ndërsa Greqia aplikon çmimin prej 35 euro për të gjitha llojet e vizave. Duke pasur parasysh këtë, kalkulimi i shpenzimeve për vit është bërë duke e nxjerrë një mesatare të çmimit dhe duke e shumëzuar atë me numrin e aplikimeve për vit dhe për tri vitet në total. Përveç kësaj, është llogaritur edhe shpenzimi që bëhet me dokumentet mbështetëse që kërkohen në aplikim, si fotografitë biometrike, sigurimi shëndetësor, nxjerrja certifikatave dhe fotokopjimi të dokumenteve. Edhe këtu llogaritja e këtij shpenzimi është bërë duke marrë një mesatare për secilën kategori.

Duhet të sqarohet që, siç u cek edhe më lart, të dhënat janë marrë nga Komisioni Europian dhe Eurostat. Këto të dhëna dallojnë në mënyre signifikante nga të dhënat që ambasadat individuale në Kosovë raportojnë. Për shembull, ambasada Zvicerane jep të dhëna që në vitin 2012 ka pasur 24,460 aplikime për viza ndërsa janë refuzuar 19.84 perqind e tyre, ndërsa sipas Komisionit Europian në të njëjtën ambasadë kanë aplikuar 17,646 aplikues dhe janë refuzuar vetëm 27 aplikacione, apo rreth 0.15 perqind. Ky konfuzion në mes të të dhënave të Komisionit Europian, Eurostat dhe shteteve individuale ekziston për shkak të vizave Shengen Limit Territorial Validity të cilat lëshohen vetëm në Kosovë për shkak të mosnjohjes së shtetit të Kosovës nga pesë vende të zonës Bashkimit Evropian (tre prej të cilave nga zona Shengen). Duke qenë të vetëdijshëm për këto dallime dhe ndryshimin që këto dallime bëjnë në modelin tonë për matjen e shpenzimeve për viza, ne do të përdorim vetëm të dhënat nga Komisioni Europian dhe Eurostat. Kjo jo për shkak të besueshmërisë më të madhe, por për arsye të mungesës së të dhënave nga ambasadat individuale në Kosovë dhe të uniformitetit të të dhënave të Komisionit Europian dhe Eurostat.

³ Applications for short-term Schengen visas in Prishtinë/Prishtina, Kosovo 2010-2011: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2013:0066:FIN:EN:PDF>

Aplikimi i kosovarëve për viza “Shengen” 2010-2012


Bazuar në statistikat zyrtare të Komisionit Europian për vitet 2010 - 2012, ambasada e Belgjikës, Gjermanisë, Greqisë, Finlandës, Hungarisë, Italisë, Sllovenisë, Zvicrës dhe Norvegjisë janë ambasadat që kanë lëshuar viza “Shengen” për qytetarët e Kosovës. Gjatë vitit 2010, në këto ambasada kanë aplikuar 82.405 qytetarë të Kosovës, në vitin 2011 kanë aplikuar 67.901 qytetarë dhe në vitin 2012 kanë aplikuar 67.556. Në total, për tri vite janë parashtruar 217.862 aplikime për vizë.

Nëse shihen ambasadat se ku ka pasur më së shumti aplikime për vizë, del se ambasada e Gjermanisë mban numrin rekord të aplikimeve gjatë këtyre tri viteve, ku në total janë parashtruar 71.942 aplikime. Pas Gjermanisë radhitet Zvicra me 58.487 aplikime për tri vite.

Nëse shohim statistikat mbi numrin e aplikacioneve të refuzuara për vizë “Shengen” në ambasadat e cekura më lartë, del se afër 10.000 aplikacione janë refuzuar në vitin 2010, afër 16.000 në vitin 2011, dhe rreth 11.600 në vitin 2012. Të tri vitet në total përbëjnë afër 37.500 aplikime të refuzuara për vizë “Shengen”. Nëse shohim dallimin në mes viteve, shihet se në vitin 2011 ka pasur rreth 6.000 refuzime më shumë se sa një vit më herët (2010). Mirëpo kjo diferencë është zvogëluar në vitet 2011 – 2012 ku numri i të refuzuarve është zvogëluar për 4.315. Ndërkaq, nëse shohim numrin e aplikacioneve të refuzuara për çdo ambasadë, del se ambasada e Gjermanisë ka shënuar numrin më të madh të refuzimeve në të gjitha vitet. Meqë pagesa për këto aplikime nuk ka rezultuar me marrjen e vizës, atëherë parat e paguara për afërsisht 37.500 aplikime, llogariten si shpenzim i humbur.

Përqindja e vizave të refuzuara sipas viteve.

Numri i aplikimeve për vizë në Prishtinë gjatë viteve 2010 dhe 2012



REFUZIME
9,910
APLIKIME
82,405

REFUZIME
15,986
APLIKIME
67,901

REFUZIME
11,671
APLIKIME
67,556

REFUZIME

Përqindja e vizave të refuzuara sipas shteteve 2010-2012

Shteti	2010	2011	2012
BEL	26%	39%	33%
GER	11%	26%	20%
GRE	4%	3%	1%
FIN	55%	53%	56%
HUN	28%	29%	29%
ITA	8%	19%	24%
SLO	18%	27%	28%
SCH	7%	21%	0%
NOR	17%	12%	17%

Viti	Lloji i vizës	Belgjika	Gjermania	Greqia	Finlanda	Hungaria	Italia	Slovenia	Zvicra ¹	Norvegjia	Totali
2010	A, B, C ²	2,945	17,080	5,496	742	3,981	1,040	3,073	4,668	759	39,784
	D ³	135	3,585	39	0	160	3,087	35	2,481	17	9,539
	LTV ⁴	5	11,629	3,749	563	8	4,301	3	12,305	519	33,082
	Të refuzuara	-816	-3,796	-378	-725	-1,175	-693	-579	-1,521	-227	-9,910
Totali i aplikimeve		3,085	32,294	9,284	1,305	4,149	8,428	3,111	19,454	1,295	82,405
2011	A, B, C	2,735	6,170	725	916	4,152	2,037	3,884	5,099	820	26,538
	LTV	0	12,526	4,083	769	1	7,066	0	16,288	630	41,363
	Të refuzuara	-1,088	-4,889	-160	-909	-1,215	-1,779	-1,080	-4,683	-183	-15,986
Totali i aplikimeve		2,735	18,696	4,808	1,685	4,153	9,103	3,884	21,387	1,450	67,901
2012	A, B, C	2,774	5,959	485	1,282	2,289	3,034	4,631	293	759	21,506
	LTV	-	14,993	3,794	968	3	8,419	-	17,353	520	46,050
	Të refuzuara	-926	-4323	-44	-1273	-671	-2844	-1336	-27	-227	11,671
Totali i aplikimeve		2,774	20,952	4,279	2,250	2,292	11,453	4,631	17,646	1,279	67,556
Totali 2010-2012		8,594	71,942	18,371	5,240	10,594	28,984	11,626	58,487	4,024	217,862



REFUZIME TË VIZAVE 2010-2012

37,567



17%

1. Këtu llogariten edhe aplikimet për shtetin e Austrisë meqë Ambasada e Zvicrës në Prishtinë pranon aplikacionet edhe për ata që destinacion kanë Austrinë.

2. Viza A është vizë me të cilën lejohet vetëm udhëtimi tranzit përmes një aeroporti të zonës "Shengen", viza B ka afat 5 ditor dhe me të lejohet tranziti me veturë brenda asaj periudhe nëpër shtetet e "Shengen"-it, viza C është me afat deri në 3 muaj brenda një periudhe prej 6 muaj të shfrytëzimit.

3. Viza D shërben për të qëndruar më gjatë se 3 muaj në shtetet e "Shengen"-it dhe zakonisht lëshohet për studime, punë, etj.

4. LTC është shkurtesë për "Limited Territorial Validity" që d.m.th se është valide për një apo më shumë shtete të "Shengen"-it dhe jo për të gjitha.

Në periudhën 2010-2012 mesatarisht janë refuzuar 17% e aplikimeve për viza.



217,862 TOTALI I APLIKIMEVE 2010-2012



Shpenzimet e kosovarëve për viza

Siç është cekur në hyrje të punimit, ambasadat që lëshojnë viza në Prishtinë nuk aplikojnë çmime të njëjta. Përveç ndryshimit të çmimeve nga ambasada në ambasade, ndryshime të çmimeve ka edhe në llojin e vizave. Për shembull, për vizat A, B, C dhe LTV ambasada e Gjermanisë aplikon çmimin e 35 eurove për vize, ndërsa ambasade e Italisë për te njëjtën aplikon çmim prej 60 eurosh. Ne anën tjetër, për viza D ambasada e Greqisë aplikon çmim prej 60 eurosh, ndërsa e ajo e Belgjikës çmim prej 180 eurosh. Në bazë të numrit të aplikuesve për secilën kategori të vizave dhe në bazë të çmimeve për secilën vizë, nëse shohim se sa kanë shpenzuar qytetarët duke aplikuar për viza, del se 9.180.805 euro janë shpenzuar për tri vite. Duke i ndarë ato, del që 3.511.547 euro janë shpenzuar në vitin 2010, 2.837.118 euro në vitin 2011, dhe 2.832.140 për vitin 2012 (tabela 2).⁴

Përveç shumës që duhet shpenzuar për aplikim për vizë, shpenzimet për të marrë një vizë nuk përfundojnë me atë. Dokumentet të cilat kërkohen nga ambasadat përfshijnë fotografi të formatit specifik që e cakton ambasada, sigurimin shëndetësor së paku për periudhën e qëndrimit, certifikata familjare apo certifikata e lindjes (varësisht prej profilit të aplikuesit dhe kërkesave të ambasadës), pasqyrën e llogarisë bankare për së paku gjashtë muaj dhe kopje të secilit dokument. Përpos këtyre dokumenteve kërkohet edhe plotësimi i aplikacionit për vizë i lëshuar ambasada. Në dyqanet përreth ambasadave ofrohen edhe shërbime me pagesë për plotësimin e këtyre aplikacioneve dhe një pjesë e konsiderueshme e aplikuesve e shfrytëzojnë këtë shërbim.

4 Përveç çmimeve specifike për viza nga ambasadat, në kalkulim është futur edhe supozimi që jo të gjithë aplikuesit paguajnë për vize. Supozimi është që 95 përqind e njerëzve paguajnë për vize, ndërsa pjesa tjetër nuk paguan për shkak të ftesës akademike, humanitare apo të qëllimeve për përfitim të gjerë social të vizitës.



Nëse shikojmë shpenzimin në dokumentet mbështetëse, më së shumti shpenzohet për sigurime shëndetësore ku afër 3.2 milion euro janë shpenzuar gjatë viteve 2010 - 2012. Në këtë rast dhe në kategoritë tjera, si fotografitë, certifikatat, është marrë një mesatare e çmimit e llogaritur me numrin e aplikimeve bazuar në tabelën paraprake. Totali i të gjitha shpenzimeve për dokumentet mbështetëse për të tri vitet është llogaritur 5.882.274. Shpenzimet në total për aplikime dhe për dokumentet mbështetëse gjatë viteve 2010 - 2012, të bëra nga qytetarët e Kosovës janë 15.063.079 milion euro (tabela 3). Duhet ceket që kjo shumë totale nuk përfshinë shpenzimet tjera të vogla apo të pamatshme që dalin gjatë aplikimit për vize, si shpenzimet për udhëtim, dhe, mbi të gjitha, kostoja oportune e kohës së shpenzuar për përgatitjen e të gjithë dokumenteve dhe pritjes në linjat e gjata për aplikim për vizë.

Duke marrë parasysh arsyetimin e ambasadave për aplikimin e çmimit të vizave, i cili thotë që me anë të kësaj shume paguhet stafi (kryesisht vendor) i cili merret me shqyrtimin e aplikacioneve, dhe faktin që për të ofruar shërbime për kërkesat tjera për vizë nevojiten njerëz të cilët i ofrojnë ato shërbime, mund të themi që këto shpenzime në viza krijojnë edhe vende pune. Për shkak se shërbimet, si fotokopjet, fotografitë dhe shërbimet tjera, ofrohen nga biznese të vogla, dhe faktit që shumë familje varen nga një individ i vetëm i cili punon, atëherë mund të themi që një numër i konsiderueshëm familjesh varen nga këto shpenzime. Gjithashtu duhet cekur që përveç efekteve direkte që këto shpenzime kanë, përmes multiplikatorit ekonomik këto efekte janë shumë më të mëdha sesa shuma e paraqitur në tabelën e mëposhtme. Me fjale tjera, ekziston një ekonomi e tërë e vizave.

Kosto direkte e vizave e vizave

Kosto direkte e vizave (pagesa për aplikim në ambasada) për kosovarët 2010-2012

KOSTO DIREKTE E VIZAVE 2010-2012

9,180,805€

GJERMANIA

1.158.919	< 2010
621.642	< 2011
696.654	< 2012
2.477.215	< TOTAL

NORVEGJIA

78.983	< 2010
82.650	< 2011
72.903	< 2012
234.536	< TOTAL

FINLANDA

61.988	< 2010
80.038	< 2011
106.875	< 2012
248.900	< TOTAL

BELGJIKA

121.173	< 2010
90.939	< 2011
92.236	< 2012
304.347	< TOTAL

ZVICRA*

924.065	< 2010
1.015.883	< 2011
838.185	< 2012
2.778.133	< TOTAL

ITALIA

612.365	< 2010
518.871	< 2011
652.821	< 2012
1.784.057	< TOTAL



Kosto e dokumenteve mbështetëse në aplikimin për vizë shprehur në euro (€)*

	2010	2011	2012	GJITHSEJ
Kosto e fotografimit	370,823	305,555	304,002	980,379 €
Sigurimi i udhëtimit	1,236,075	1,018,515	1,013,340	3,267,930 €
Kosto e Çertifikatave	82,405	67,901	67,556	217,862 €
Shërbimet bankare	164,810	135,802	135,112	435,724 €
Fotokopje dhe shërbime tjera	370,823	305,555	304,002	980,379 €
Total (pagesa direkt në ambasada)	2,224,935 €	1,833,327 €	1,824,012 €	5,882,274 €
Grand total	5,736,482 €	4,670,445 €	4,656,152 €	15,063,079 €

* Kostot e këtyre shërbimeve janë të bazuara në çmimet e këtyre shërbimeve, numrin e aplikantëve, dhe supozime mbi numrin e aplikantëve të cilët përdorin këto shërbime (si në rastin e mbushjes së formularit, apo në nxjerrjen e certifikatave)

HUNGARIA

141.754 < 2010
138.087 < 2011
76.209 < 2012
356.051 < TOTAL

KOSTO E APLIKIMIT PER VIZE DHE DOKUMENTEVE MBESHTETESE 2010-2012

15,063,079€

SLLOVENIA

103.607 < 2010
129.143 < 2011
153.981 < 2012
386.731 < TOTAL

2.477.215

GJERMANIA

SHTETI ME MË SË SHUMTI PËRFITIM NGA APLIKIMI PËR VIZA I QYTETARËVE TË KOSOVËS

GREQIA

308.693 < 2010
159.866 < 2011
142.277 < 2012
610.836 < TOTAL

234.536

NORVEGJIA

SHTETI ME MË SË PAKU PËRFITIM NGA APLIKIMI PËR VIZA I QYTETARËVE TË KOSOVËS



6 Në rast se do t'i përdornim të dhënat e ambasadës së Zvicrës për vitet 2011 – 2012, atëherë shpenzimet do të kapnin shumën e 1,161,850 eurove për vitin 2011 dhe 1,129,550 euro për vitin 2012. Totali i tre viteve do të ndryshonte prej 2,832,140 euro në 3,215,465 euro.

Përfundim

Kosova ende mbetet larg nga plotësimi i kriterëve për liberalizim të vizave. Së paku edhe në vitin 2013 kosovarët do të jenë të vetmin qytetarë të Europës të cilëve u kërkohet viza për të hyrë në vendet e zonës “Shengen”. Nëse shohim trendin e aplikimeve për çdo vit nga viti 2010, mund të pritët se edhe në vitin 2013 më shumë se 65.000 kosovarë do të aplikojnë për viza me një kosto shtesë së paku edhe për 4.5 milion euro.

Përkundër përpjekjeve për të vënë një çmim procedurave të shumta për marrjen e vizave, jo gjithçka mund të monetarizohet. Shumë qytetarë të Kosovës detyrohen të shpenzojnë shumë më shumë për të aplikuar për vizë, se sa çmimet që i kemi përshkruar në këtë raport analitik. Shumë qytetarë duhet të ndërpresin punën e tyre të përditshme, faktor të cilit është vështirë ti vihet një vlerë monetare. Gjithashtu, në këtë kalkulim nuk janë përfshirë shpenzimet e udhëtimit, të cilat qytetarët detyrohen ti paguajnë në formë të biletës për transport publik apo karburante për vetura, për të udhëtuar deri në ambasadë për aplikim.

Përkundër asaj se një kategori e caktuar e bizneseve, siç janë fotografët, kompanitë e sigurimeve, agjencionet turistike, shërbimet e përkthimit, etj., përfitojnë nga procedurat për aplikim për viza, prapë se prapë ky proces bart implikime të mëdha ekonomike dhe shoqërore.

